



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1010

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) PRO MEDICAL SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të KOMUNA SUHAREKË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë me numër të prokurimit 624-25-2455-1-2-1, me 27.11.2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE PRO MEDICAL SH.P.K., me nr. 2025/1010, e datës 10.10.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë me numër të prokurimit 624-25-2455-1-2-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KOMUNA SUHAREKË, ndërkah aktiviteti i prokurimit Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë me numër të prokurimit 624-25-2455-1-2-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 02.04.2025 KOMUNA SUHAREKË, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë me numër të prokurimit 624-25-2455-1-2-1.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar **procedurën e hapur**, me **lloj kontrate: furnizim**, dhe **vlerë të parashikuar të kontratës: 50,000.00 €**.

Me 23.09.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është anuluar aktiviteti i prokurimit.

Me 29.09.2025, OE PRO MEDICAL SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 01.10.2025.

Me 10.10.2025, OE PRO MEDICAL SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1010, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K., lidhur me ankesën 1010/2025:

AK – KOMUNA SUHAREKË në aktivitetin e “Blerja dhe pajisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë”, ky aktivitet i prokurimit të lartpërmendur është anuluar në kundërshtim me LPP. Në vendimin e OSHP-së me nr. 0503/2025 janë konstatuar të gjitha pretendimet tona, duke u vërtetuar se rekomandimi i AK-së për dhënien e kontratës operatorit ekonomik Letamed, si dhe eliminimi ynë, kanë qenë në kundërshtim me LPP dhe lënda është rikthyer në rivlerësim sipas vendimit të OSHP-së.

Në momentin kur AK e kishte rekomanduar OE Letamed për kontratë, kishte mjete financiare të planifikuara për realizimin e saj. Mirëpo, pas rikthimit të lëndës në rivlerësim sipas vendimit të OSHP-së, AK merr vendim për anulim me arsyetimin e mungesës së mjeteve financiare, por ky arsyetim nuk qëndron, ku më poshtë dëshmoj me prova dhe dëshmi. Vendimi i AK bie ndesh me LPP dhe është në kundërshtim me parimet bazë të saj, konkretisht me nenin 62 dhe nenin 7 të LPP.

Neni 1 – Qëllimi – E kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues ngase i njëjti është në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit për Prokurim Publik dhe paragrafin nuk ka marrë në konsideratë detyrimin. AK në këtë rastin tonë ka shkelur nenin 1 paragrafin 2 të LPP, citim: “Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publikë, nëpunësve civilë dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.”

Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi – Ne, Pro Medical, nuk jemi trajtuar si të barabartë nga AK. AK nuk e ka respektuar dispozitat e LPP, ku anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit bie ndesh me nenin 62 të LPP-së. Edhe kësaj here, na është mohuar e drejta që të shpërblehemi me kontratë në përputhje me LPP dhe ne jemi diskriminuar nga AK.

Në vendimin e AK për anulim është cekur se lidhur me arsyetimin e AK ai nuk qëndron, pasi penalizimi i OE vjen si rezultat i neglizhencës së AK-së dhe mungesës së veprimeve të saj. AK merr vendim në kundërshtim me A002 Versioni i Konsoliduar – Rregullore Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022.

Pra arsyetimi i AK-së nuk qëndron dhe ne nuk mund të penalizohemi si kompani për mungesën e veprimeve nga ana e AK-së, pasi ne si operator ekonomik nuk jemi përgjegjës për menaxhimin e financave publike. Ky aktivitet i prokurimit është planifikuar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) dhe me planin e prokurimit të dorëzuar, ku edhe mjetet financiare kanë qenë të disponueshme gjatë kësaj faze, siç shihet më poshtë.

PLANIFIKIMI PËRFUNDIMTAR I PROKURIMIT – Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-042, Ligji mbi Prokurimin Publik për vitin fiskal 2025 ka qenë si më poshtë ose shikoni PLANIFIKIMIN PËRFUNDIMTAR TË PROKURIMIT si dëshmi. Prandaj, një arsyetim i tillë nuk mund të cenojë të drejtën tonë që na garantohet nga LPP dhe Pro Medical është diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit. Kompania jonë i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues, fatkeqësisht AK nuk na ka shpërblyer me kontratë por në kundërshtim të plotë me LPP, konkretisht nenin 62 të LPP dhe nenin 43 të RRPP 002/2024 ka marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Këtë veprim të AK ne e konsiderojmë edhe si favorizim të OE Letamed, i cili në vendimin e parë të AK-së është rekomanduar për kontratë në kundërshtim me LPP pasi ka pasur ofertë të papërgjegjshme, për faktin se AK me anulimin e aktivitetit të prokurimit po e favorizon këtë OE përsëri duke i dhënë mundësi që edhe një herë të ofertojë në aktivitetin e prokurimit që AK pretendon se do ta ri-tenderojë, pra veprim apo shkresa nga QKMF është bërë me qëllim vetëm mohimin tonë që rekomandohemi për kontratë.

Me datën 27.08.2025 kemi pranuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) dokumentin B47 – Letër standarde e kërkesës për sqarim të tenderit për tenderin “Blerja e pajisjeve për QKMF – GOE PRO MEDICAL”. Në përgjigje të kësaj kërkeje, me datën 01.09.2025 kemi dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara nga AK. Pas kësaj date, AK ka filluar verifikimin e dokumenteve të dorëzuara nga ne duke kontaktuar bashkëpunëtorët tanë afarist. Megjithatë disa herë kemi kërkuar informacione nga AK lidhur me ecurinë e këtij procesi, AK ka refuzuar të na informojë për statusin e verifikimit (shiko email tek AK). Duke pasur parasysh obligimet dhe marrëveshjet që kemi me partnerët tanë afarist, pasi i kemi informuar se tenderi është anuluar, ata na kanë informuar se janë kontaktuar nga ZPP në Suharekë për verifikimin e dokumenteve. Sipas informacioneve të pranura, të gjitha dokumentet tona janë vlerësuar si autentike dhe origjinale.

Pavarësisht këtij fakti, AK, duke marrë për bazë dokumentacionin e dorëzuar prej nesh dhe në kundërshtim me provat ekzistuese, ka marrë vendim për anulimin e tenderit. Ky veprim është diskriminues ndaj nesh dhe na ka mohuar të drejtën për t’u shpërblyer me kontratë, ndonëse kemi përmbushur të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit (DT). Në bashkëngjitje të këtij emaili janë përfshirë disa shkresa të pranura nga partnerët tanë afarist, të cilat dëshmojnë se veprimi i AK për anulim ka dëmton imazhin dhe reputacionin e kompanisë sonë, si dhe ka shkaktuar dëme

financiare për shkak të humbjes së besimit dhe prishjes së marrëdhënieve afariste.

Për këto arsye, kërkojmë që OSHP të aprovojë ankesën tonë, pasi anulimi i tenderit është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), Nenin 62, si dhe me Rregulloren për Prokurim Publik Nr. 002/2024. Kurse AK është i detyruar të respektojë nenin 62 të LPP-së, si dhe dispozitat e Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, konkretisht nenin 43.5 dhe 43.7.

Siç kemi cekur më lart, buxheti i planifikuar për vitin 2025 për këtë kategori është në vlerë prej 50,000 euro, dhe procedurat e prokurimit kanë filluar në përputhje me LPP. Megjithatë, AK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të siguruar që ky aktivitet i prokurimit të përfundojë në përputhje me LPP, përveç një emaili të pranuar nga QKMF. Ne kemi dyshime se arsyetimi se “nuk ka pasur mjete financiare të disponueshme” nuk qëndron, pasi buxheti për këtë aktivitet ka qenë i planifikuar dhe i parapaguar në përputhje me planin e prokurimit.

Gjithashtu, duke marrë parasysh që ky tender ishte paraparë dhe të favorizojë OE “LETAMED” nga Suhareka, dhe pas vendimit të OSHP-së të përmendur më lart pra 0503/2025 ku është konstatuar qartë se operatori ekonomik PRO MEDICAL është diskriminuar, ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar në atë fazë ka qenë i favorizuar, rezulton se vendimi i AK-së për anulim të tenderit është marrë në kundërshtim të plotë me LPP, Nenin 62 dhe Nenin 7 të LPP.

Ky veprim i AK lë të kuptohet se ka pasur qëllim diskriminimin e kompanisë sonë Pro Medical, duke na mohuar të drejtën për t’u rekomanduar për kontratë. Në kohën kur keni rekomanduar OE Letamed, buxheti ka qenë i planifikuar dhe i disponueshëm. Tani, duke marrë parasysh se ky OE është shpallur i papërgjegjshëm, ju keni marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Një veprim i tillë lë të kuptohet se është ndërmarrë me qëllim të krijimit të mundësisë së dytë për OE Letamed, gjë që bie ndesh me parimet e LPP-së. Ky vendim për anulim bie ndesh me LPP.

Neni 62 – Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit – Duke u bazuar në këtë nen, AK i lejohe vetëm në dy raste kur mund të anulohet tenderin pas hapjes publike si citim paragrafi 1: “Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet: 1.1. një shkellje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.” (pra para hapjes së ofertave).

Neni 62 i LPP-së përcakton qartë rastet se kur mund të përfundojë një aktivitet i prokurimit. Po ashtu, neni 43.5 i Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik përcakton rastet kur është e mundur ndërprerja e procedurës së prokurimit. Mirëpo, arsyetimi i dhënë nga AK për ndërprerjen e kësaj procedure nuk përfshihet në këto dispozita ligjore. Prandaj, AK është i obliguar që çdo veprim ta ndërmarrë në përputhje me dispozitat ligjore dhe të sigurojë ligjshmërinë e secilit hap të procedurës së prokurimit.

Me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, AK nuk ka respektuar asnjë nga dispozitat e nenit 62 të LPP-së. Gjithashtu, neni 43.5 i Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik shprehet shumë qartë lidhur me rastet kur një aktivitet i prokurimit mund të anulohet. Pra, arsyetimi i dhënë nga AK në këtë rast bie ndesh si me dispozitat e LPP-së, ashtu edhe me nenin 43.5 të Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik (2022), ku specifikohet qartë se në cilat raste një tender mund të anulohet pas hapjes së ofertave.

Pra, asnjë bazë ligjore sipas LPP-së dhe Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik nuk është përmbushur që të anulohet ky aktivitet i prokurimit. Neni 43.5 i Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik shumë qartë në paragrafin 43.5 shpreh se kur mund AK të anulojë një aktivitet të prokurimit. Arsyetimi i AK në këtë rast bie ndesh si me LPP ashtu edhe me Rregulloren Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik 2022, e cila qartë e specifikon kur një tender mund të anulohet pas hapjes.

43.5 – Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

- a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
- c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3 (tre);
- d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/konkurruese me negociata është më pak se 3;
- f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
- h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
- i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
- j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-së është i pariparueshëm;
- k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

43.7 – Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:

- a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Për këtë arsye, ne si operator ekonomik kërkojmë nga OSHP anulimin e vendimit të AK-së dhe që lënda të kthehet në rivlerësim, në mënyrë që të sigurohet respektimi i dispozitave ligjore dhe trajtimi i barabartë i të gjithë operatorëve ekonomikë. AK, duke përdorur këtë praktikë të anulimit në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), ka krijuar predispozitë për abuzim me dispozitat e LPP-së.

Ky vendim për anulim bie ndesh me Rregulloren Nr. 002/2024, Nenin 97 – Shkeljet e rënda, pika (k), e cila përcakton se: “Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të

Ligjit për Prokurimin Publik” përbën shkelje të rëndë. Për këto arsye, kërkojmë që ky rast të trajtohet nga KRPP, me qëllim që të ndërmerren veprimet e nevojshme ndaj Autoritetit Kontraktues për shkeljen e dispozitave ligjore.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: Grup i Operatorëve Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K.; PHARMA GROUP, Rr. Kadri Zeka, 70000, Ferizaj, me adresë në Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Blerja dhe pajisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë” me numër të prokurimit: 624-25-2455-1-2-1, numër i brendshëm: 624-25-23-121, kundër (NJOFTIM MBI VENDIM TË AK), të datës 23.09.2025, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë 29.09.2025 sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Përgjigje ndaj pretendimeve ankimore – Shkelja e nenit 1 të LPP (Qëllimi, integriteti, transparenca) nuk qëndron. OE ankues pretendon se anulimi bie ndesh me qëllimin e LPP-së dhe parimet e integritetit e transparencës. Anulimi është marrë për të parandaluar dhënien e një kontrate pa mbulim buxhetor, që do të përbënte shkelje të kuadrit ligjor dhe parimeve të menaxhimit të financave publike. Marrja e një vendimi që ndalon realizimin e një shkeljeje është në përputhje me qëllimin, integritetin dhe transparencën që kërkon LPP.

Shkelja e nenit 7 të LPP (Barazia/Jo-diskriminimi) dhe “favorizim” i OE tjetër nuk qëndron. OE ankues pretendon se kemi favorizuar OE “Letamed” me faktin e anulimit dhe mundësisë së ritenderimit. AK ka vepruar njësoj ndaj të gjithë ofertuesve dhe nuk prodhon efekt selektiv. Ritenderimi është procedurë e re, e hapur për të gjithë OE-të, me kushte të barabarta, andaj nuk keni asnjë provë për trajtim të pabarabartë.

OE ankues pretendon se arsyetimi i AK për mungesë fondesh nuk përfshihet në rastet e lejuara pas hapjes së ofertave. Vazhdimi i procedurës drejt dhënies pa fonde do të shkaktonte shkelje të ligjit, andaj AK nuk mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale në mungesë të fondeve.

OE ankues pretendon se “Neglizhencë e AK-së” dhe ekzistenca e buxhetit 50,000 € (planifikimi) nuk qëndron. Mjetet e ndara të cilat kanë qenë për këtë aktivitet nuk garantojnë padryshueshmëri të fondeve; ndryshimet kanë ardhur nga procedurat përmbarimore. AK nuk mund të procedojë drejt dhënies/nënshkrimit të kontratës pa fonde buxhetore.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 10.10.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1010, ndërsa me datë 24.10.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1010. Grup i Operatorëve Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K.; PHARMA GROUP, Rr. Kadri Zeka, 70000, Ferizaj, me adresë në Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Blerja dhe pajisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë” me numër të prokurimit: 624-25-2455-1-2-1, numër i brendshëm: 624-25-23-121, kundër (NJOFTIM MBI VENDIM TË AK), të datës 23.09.2025, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net> ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë 29.09.2025 sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Përgjigje ndaj pretendimeve ankimore – Shkelja e nenit 1 të LPP (Qëllimi, integriteti, transparencë) nuk qëndron. OE ankues pretendon se anulimi bie ndesh me qëllimin e LPP-së dhe parimet e integritetit e transparencës. Anulimi është marrë për të parandaluar dhënien e një kontrate pa mbulim buxhetor, që do të përbënte shkelje të kuadrit ligjor dhe parimeve të menaxhimit të financave publike. Marrja e një vendimi që ndalon realizimin e një shkeljeje është në përputhje me qëllimin, integritetin dhe transparencën që kërkon LPP.

Shkelja e nenit 7 të LPP (Barazia/Jo-diskriminimi) dhe “favorizim” i OE tjetër nuk qëndron. OE ankues pretendon se kemi favorizuar OE “Letamed” me faktin e anulimit dhe mundësisë së ritenderimit. AK ka vepruar njësoj ndaj të gjithë ofertuesve dhe nuk prodhon efekt selektiv. Ritenderimi është procedurë e re, e hapur për të gjithë OE-të, me kushte të barabarta, andaj nuk keni asnjë provë për trajtim të pabarabartë.

OE ankues pretendon se arsyetimi i AK për mungesë fondesh nuk përfshihet në rastet e lejuara pas hapjes së ofertave. Vazhdimi i procedurës drejt dhënies pa fonde do të shkaktonte shkelje të ligjit, andaj AK nuk mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale në mungesë të fondeve.

OE ankues pretendon se “Neglizhencë e AK-së” dhe ekzistenca e buxhetit 50,000 € (planifikimi) nuk qëndron. Mjetet e ndara të cilat kanë qenë për këtë aktivitet nuk garantojnë padryshueshmëri të fondeve; ndryshimet kanë ardhur nga procedurat përmbarimore. AK nuk mund të procedojë drejt dhënies/nënshkrimit të kontratës pa fonde buxhetore.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE është pajtur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEPRO MEDICAL SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1010, ka vlerësuar si në vijim:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

OE “PRO MEDICAL SH.P.K.” ka paraqitur ankesë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit “Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF ‘Rexhep Kuçi’ Suharekë”, duke pretenduar se arsyetimi për mungesë fondesh është i pabazuar, pasi buxheti ishte planifikuar. Ankuesi vlerëson se vendimi bie ndesh me nenet 1, 7 dhe 62 të LPP-së dhe nenin 43 të Rregullores Nr. 002/2024, si dhe përbën diskriminim dhe favorizim të OE “LETAMED”. Në mbështetje të qëndrimit të tij, i referohet vendimit të OSHP-së nr. 2025/0503, ku ishte urdhëruar rivlerësimi i lëndës. Ankuesi kërkon anulimin e vendimit të AK-së dhe kthimin e lëndës në

rivlerësim.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes ankesën e paraqitur nga Operator Ekonomik “PRO MEDICAL SH.P.K.” – Prishtinë, kundër Autoritetit Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF ‘Rexhep Kuçi’ Suharekë” (nr. i prokurimit: 624-25-2455-1-2-1).

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, vendimeve të AK-së, dokumenteve të bashkëngjitura nga pala ankues, si dhe akteve të mëparshme të OSHP-së që lidhen me këtë lëndë, përkatësisht vendimit nr. 2025/0503 datë 07.08.2025, eksperti shqyrtues paraqet analizën si vijon:

Pretendimi Ankimor:

Operatori ekonomik “PRO MEDICAL SH.P.K.” pretendon se Autoriteti Kontraktues – Komuna e Suharekës ka vepruar në kundërshtim me LPP-së dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Prokurim Publik (RrPP), duke anuluar aktivitetin e prokurimit “Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF ‘Rexhep Kuçi’ – Suharekë” në mënyrë të kundërligjshme.

Sipas ankuesit, ky aktivitet është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 7 – Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi, si dhe me nenin 43 të RrPP-së.

Në ankesë thuhet se vendimi për anulim i AK-së bie ndesh me qëllimin dhe parimet bazë të LPP-së, sepse arsyeja e dhënë për anulim – “mungesa e mjeteve financiare” – nuk qëndron dhe nuk përfshihet në asnjë nga rastet e lejuara ligjërisht për përfundim të aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave.

Ankuesi thekson se në kohën kur AK kishte rekomanduar operatorin “LETAMED” për kontratë, mjetet financiare kanë qenë të planifikuara dhe të disponueshme, ndërsa pas rikthimit të lëndës për rivlerësim sipas vendimit të OSHP-së nr. 0503/2025, AK ka marrë vendim për anulim me arsyetimin e mungesës së mjeteve financiare, arsyetim i cili, sipas tij, nuk qëndron dhe nuk mbështetet në prova.

Në ankesë theksohet se ky veprim bie ndesh me nenin 1 të LPP-së, i cili garanton integritetin, përgjegjshmërinë dhe jo-diskriminimin në vendimmarrjen publike, dhe me nenin 7 të LPP-së, sepse operatori “PRO MEDICAL” nuk është trajtuar si i barabartë dhe i është mohuar e drejta për t’u shpërblyer me kontratë, ndonëse i ka përmbushur të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Ankuesi deklaron se arsyetimi i AK-së për mungesë fondesh lidhet me neglizhencën e vetë AK në menaxhimin e mjeteve buxhetore, për çka operatori ekonomik nuk mund të penalizohet.

Ai shton se ky aktivitet i prokurimit është planifikuar dhe buxhetuar sipas ligjit, dhe se arsyetimi për mungesë fondesh është përdorur për të favorizuar operatorin “LETAMED”, i cili më parë ishte rekomanduar në kundërshtim me LPP-në, ndërsa “PRO MEDICAL” ishte eliminuar padrejtësisht.

Në ankesë përmendet gjithashtu se me datën 27.08.2025, operatori ka pranuar nga AK dokumentin B47 – kërkesë standarde për sqarim të tenderit, dhe me datën 01.09.2025 ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara.

Pas kësaj, AK ka kryer verifikime tek bashkëpunëtorët afarist të kompanisë, ndërsa ka refuzuar të ofrojë informacion mbi statusin e procesit, megjithëse Zyra e Prokurimit Publik (ZPP) në Suharekë ka verifikuar se të gjitha dokumentet e dorëzuara nga OE janë autentike dhe origjinale.

Pavarësisht kësaj, AK ka marrë vendim për anulim të tenderit, çka ankuesi e cilëson si veprim diskriminues dhe të ndërmarrë në kundërshtim me provat ekzistuese.

Në ankesë thuhet se ky vendim i AK-së ka dëmtuar imazhin dhe reputacionin e kompanisë, si dhe ka shkaktuar dëme materiale për shkak të humbjes së besimit dhe prishjes së marrëdhënieve afariste.

Në përmbyllje, operatori ekonomik kërkon nga OSHP që të aprovojë ankesën si të bazuar, të anulojë vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit, dhe që lënda të kthehet në rivlerësim, në mënyrë që të sigurohet respektimi i dispozitave ligjore dhe trajtimi i barabartë i operatorëve ekonomikë.

Përgjigjja e Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “PRO MEDICAL SH.P.K.” dhe shqyrtimit të dokumentacionit të plotë të lëndës, ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Suharekës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja dhe pajisja me aparaturë të nevojshme për QKMF ‘Rexhep Kuçi’ – Suharekë” (nr. i prokurimit: 624-25-2455-1-2-1).

1. Sa i përket arsytimit buxhetor

Autoriteti Kontraktues e ka arsyetuar anulimin e procedurës me mungesë të mjeteve buxhetore, duke deklaruar se për shkak të një procedure përmbarimore nuk mund të siguroheshin fondet për realizimin e kontratës.

Për të verifikuar bazueshmërinë e këtij arsytimi, më 24.10.2025, eksperti shqyrtues i është drejtuar AK-së me kërkesë për sqarime (Ref. 176/2025), duke kërkuar:

- konfirmimin e gjendjes aktuale të fondeve për projektin buxhetor nr. 52936;
- kopje të dokumenteve përmbarimore ose aktvendimeve përkatëse;
- dhe çdo vendim financiar që mbështet arsyetimin për anulim të aktivitetit.

Në përgjigje, AK ka dorëzuar një raport përmbledhës nga Zyrtari Kryesor Financiar, në të cilin janë paraqitur tërheqje të mjeteve në shumën 22,663.00 €, të shënuara si “përmbarim” në datat 26.07.2025 dhe 01.09.2025.

Në raportin financiar të dorëzuar nuk janë përfshirë dokumente mbështetëse që vërtetojnë ligjshmërinë e transaksioneve të pretenduara si “përmbarim”. Kjo mungesë e dokumentacionit provues e bën të pamundur verifikimin e bazueshmërisë ligjore të këtij arsytimi financiar.

Në anën tjetër, nga dokumentet e shqyrtuara – përfshirë B04 “Deklarata e Nevojave dhe Disponueshmërisë së Fondeve” (datë 30.05.2025) dhe Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2025 – rezulton se fondet për këtë projekt kanë qenë të planifikuara dhe të zotuar paraprakisht.

Në bazë të nenit 62 të LPP-së dhe nenit 43 të RrPP-së, anulimi i një procedure pas hapjes së ofertave mund të bëhet vetëm në raste të përcaktuara qartë me ligj — si mungesa e ofertave të përgjegjshme, tejkalimi i buxhetit nga të gjitha ofertat, apo ndryshimet thelbësore të nevojës.

Në rastin konkret, asnjë nga këto kushte nuk është evidentuar, ndërsa nuk janë paraqitur prova ligjore që justifikojnë ndërprerjen e aktivitetit për arsye buxhetore.

Në përputhje me nenet 1 dhe 7 të LPP-së, që garantojnë ligjshmërinë, transparencën dhe përgjegjshmërinë në menaxhimin e fondeve publike, eksperti shqyrtues vlerëson se vendimi për anulim nuk është mbështetur në prova të verifikueshme dhe bie ndesh me qëllimin e ligjit për zbatim të drejtë dhe të paanshëm të procedurave të prokurimit.

Vendimi për anulim vlerësohet si i pambështetur në prova ligjore dhe faktike dhe bie ndesh me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RrPP-së.

2. Sa i përket procesit të rivlerësimit dhe kërkesave për sqarim

Nga shqyrtimi i dokumenteve të lëndës dhe vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit nr. 2025/0503, datë 07.08.2025, rezulton se Paneli Shqyrtues ka urdhëruar kthimin e aktivitetit në fazën e rivlerësimit të ofertave, duke e detyruar AK-në të ndërmarrë veprimet përkatëse në përputhje me dispozitivin dhe arsyetimin e vendimit.

Pas marrjes së këtij vendimi, AK ka ndërmarrë veprime për verifikimin e dokumenteve të autorizimit, duke dërguar më 08.09.2025 kërkesa zyrtare për konfirmim te prodhuesit AIM Surgical Devices dhe Shenzhen Comen Medical Instruments CO. LTD. Në përgjigje, prodhuesit kanë konfirmuar me shkrim se “PRO MEDICAL SH.P.K.” është distributori i tyre i vetëm për Kosovë dhe se autorizimet e dorëzuara janë origjinale dhe të vlefshme.

Eksperti sqaron se, në përputhje me nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, është e drejtë procedurale dhe legjitime që Autoriteti Kontraktues, në rast paqartësish, të kërkojë sqarime shtesë nga operatori ekonomik.

Nga dokumentet rezulton gjithashtu se operatori ankues i është drejtuar AK-së me kërkesë për informim lidhur me veprimet e ndërmarra pas dorëzimit të dokumenteve më 01.09.2025, duke kërkuar:

njoftim për veprimet e ndërmarra nga AK pas dorëzimit të dokumenteve;

kopje të kërkesave të adresuara te partnerët afaristë;

dhe kopje të përgjigjeve të pranuar prej tyre.

Në përgjigje, AK ka deklaruar se Komisioni ka qenë në fazën e rivlerësimit të aktivitetit, mirëpo pas pranimit të emailit zyrtar nga njësia kërkuese – me të cilin është informuar se për këtë aktivitet nuk janë planifikuar mjetet buxhetore të nevojshme – është marrë vendim për anulimin e procedurës së prokurimit, në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Për këtë arsye, raporti i rivlerësimit nuk është finalizuar dhe nuk ekziston si dokument i plotë për t'u përcjellë.

Eksperti sqaron se vendimi i OSHP-së ka urdhëruar rivlerësimin e procedurës, dhe AK kishte detyrimin ligjor që ta përmbyllte këtë proces në përputhje me dispozitivin dhe qëllimin e vendimit, pa e ndërprerë apo zëvendësuar me veprime të tjera që ndryshojnë natyrën e tij. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit dhe zëvendësimi i tij me anulim përbën moszbatim të vendimit të OSHP-së dhe nuk është në pajtim me parimin e ligjshmërisë të parashikuar në nenin 7 të LPP-së.

PËRFUNDIMI

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të lëndës dhe vendimit të OSHP-së nr. 2025/0503, eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa e operatorit ekonomik “PRO MEDICAL SH.P.K.” të aprovohet si e bazuar.

Autoriteti Kontraktues nuk ka siguruar që procesi i rivlerësimit është zhvilluar në pajtim me vendimin OSHP-së, i cili kërkonte kthimin e lëndës në fazën e rivlerësimit të ofertave. Procesi është ndërprerë para përfundimit dhe është zëvendësuar me vendim për anulim të procedurës, me arsyetimin “mungesë e mjeteve financiare”, pa paraqitur prova të mjaftueshme ligjore dhe faktike që ta mbështesin një veprim të tillë.

Ky veprim përbën moszbatim të vendimit të OSHP-së dhe bie ndesh me nenin 105 paragrafi 2.10 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton kompetencat e OSHP-së për të urdhëruar autoritetin kontraktues që të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe të sigurojë zbatim të vendimit, si dhe me nenin 7 të po të njëjtit ligj, që garanton ligjshmëri, barazi dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Duke qenë se fondet për këtë projekt kanë qenë të planifikuara paraprakisht dhe vendimi për anulim nuk është mbështetur në dokumente provuese, eksperti shqyrtues vlerëson se lënda duhet të kthehet në fazën e rivlerësimit, në përputhje me vendimin e OSHP-së nr. 2025/0503 dhe me kërkesat e nenit 59 të LPP-së, duke siguruar që procesi të përfundojë në mënyrë të drejtë, transparente dhe të paanshme.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit. Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë me numër të prokurimit 624-25-2455-1-2-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: